



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1014/4 Prot.

Tiranë, më 06 . 11 . 2023

V E N D I M

Nr. 225 , Datë 06 . 11 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 172 Regj., datë 19.09.2023, të shtetases M. K, kundër: Çerdhes Nr. 16, “Borëbardha”, Tiranë dhe Kopshtit Nr. 25/1 “Duarartët”, Tiranë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të racës<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

K O N S T A T O I:

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “...Në muajin Qershor 2023 jam paraqitur pranë Kopshtit “Duarartët” dhe Çerdhes “Borëbardha”, Tiranë, për të regjistruar vajzën time E, në Kopsht dhe djalin tim M, në Çerdhe. Më parë kam jetuar në Athinë, në shtetin grek dhe pasi u ktheva në Tiranë, e vetme me dy fëmijët, jetoj pranë prindërve të mi. Kam plotësuar e dorëzuar të gjitha dokumentet për regjistrimin e fëmijëve, por deri në këto momente nuk më kanë regjistruar asnjërin nga fëmijët. Kur kam pyetur pranë Kopshtit e Çerdhes më kanë thënë se këtë punë e ka në dorë Drejtoria pranë Bashkisë. Kur kam pyetur pranë Drejtorisë tek Bashkia më kanë thënë se e ka në dorë Kopshti e Çerdhja. Ndihem e nëpërkëmbur dhe e diskriminuar pasi mendoj se fëmijët nuk m’i regjistrojë për shkak të racës, pasi jemi

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit të lëshuar nga Organizata “Qendra T’REJA”, subjekti ankues i përket komunitetit rom Shqipëri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

*komunitet rom. Unë jam e punësuar te një restorant dhe nëse fëmijët e mi nuk regjistrohen që të mund t'i dërgoj në Çerdhe e Kopsht, rrezikoj të humbas edhe punën, me të cilën mbaj familjen.”*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndërhyjë pranë instancave përkatëse në mënyrë që të regjistrohen fëmijët e saj në kopsht e çerdhe.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1014/1 prot., datë 21.09.2023, nga ana e KMD-së i është kërkuar informacion lidhur me pretendimin e subjektit ankues, subjekteve të: Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, pranë Bashkisë Tiranë, Kopshtit Nr. 25/1 “Duarartët” dhe Çerdhes Nr. 16 “Borëbardha”.

---

<sup>3</sup>Shkurtesë për ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, nëpërmjet shkresës me nr. 1249/1 prot., datë 26.09.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve<sup>4</sup>, informon si më poshtë citohet:

*“Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve (DPÇK) ka shpallur periudhën e aplikimeve për regjistrimin e fëmijëve në çerdhet dhe kopshtet publike të Bashkisë Tiranë, afishuar në çdo çerdhe e kopsht, si dhe në faqen zyrtare në web dhe në rrjete sociale.*

*Procedura e aplikimeve për regjistrim në çerdhe për sezonin 2023-2024 ka qenë data 05.06.2023 deri në datën 09.06.2023 dhe për regjistrimin në kopshte për sezonin 2023-2024, ka qenë nga data 12.06.2023 deri më datë 23.06.2023, respektivisht linqet si më poshtë:*

<https://femijetetiranes.al/aplikimet-per-regjistrimin-e-femijeve-ne-cerdhet-publike-te-bashkise-se-tiranes-per-sezonin-2023-2024;>

<https://femijetetiranes.al/aplikimet-per-regjistrimin-e-femijeve-ne-kopshtet-publike-te-bashkise-se-tiranes-per-sezonin-2023-2024.>

*Gjatë periudhave sipërpërmendur të gjithë prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve të interesuar për të marrë këtë shërbim, janë paraqitur pranë çerdheve dhe kopshteve përkatëse, kanë plotësuar formularin e aplikimit dhe kanë depozituar dokumentacionin referuar kritereve të publikuara.*

*Pas verifikimit të kryer nga DPÇK, rezultoi se nuk ka asnjë aplikim për fëmijën E, nga nëna e saj M. K, pranë Kopshtit Nr. 25/1 “Duarartët”, si dhe rezultoi se nuk ka asnjë aplikim për fëmijën M, nga nëna M. K, pranë Çerdhes nr. 16 “Borëbardha”.*

*Znj. K, e cila i është drejtuar Komisionerit, nuk ka aplikuar gjatë periudhës së aplikimit, si dhe nuk ka depozituar dokumentat përkatëse pranë Çerdhes dhe Kopshtit.*

*Lidhur me pretendimin e znj. K se fëmijët e saj nuk janë regjistruar për shkak të përkatësisë racore, sjellim në vëmendjen tuaj se, DPÇK, si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, në zbatim të VKB nr. 158, datë 26.12.2019 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, ka përcaktuar si një nga kategoritë prioritare, fëmijët e familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, si dhe i ka përjashtuar ata nga pagesa e tarifës së çerdhes dhe kopshtit për të gjithë fëmijët frekuentues të çerdheve dhe kopshteve publike.*

*Aktualisht, vetëm në muajin shtator 2023, janë rreth 180 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, që frekuentojnë kopshtet e çerdhet publike të Tiranës, të cilët nuk paguajnë tarifën e përcaktuar për marrjen e shërbimit në këto institucione, pra e marrin atë falas.*

---

<sup>4</sup> Dërguar për dijeni edhe subjektit ankues.

*Institucioni ynë në përmbushje të misionit të këtij institucioni për mirërritjen dhe zhvillimin e të gjithë fëmijëve, pa dallime, si dhe duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, në çdo kohë dhe çdo rrethanë, ka rritur gamën e kategorive përfituese të shërbimit falas, duke e bërë atë gjithëpërfshirëse.*

*Përsa i përket kërkesës tuaj, në lidhje me masat që mund të marrë institucioni ynë për zgjidhjen e kësaj problematike, sqarojmë se, në varësi të kapaciteteve të secilës çerdhe apo kopsht, znj. K do të njoftohet menjëherë”.*

- *Më shkresën me nr. 32770/2 prot., datë 29.09.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale/Bashkia Tiranë, është përcjellë për kompetencë dhe për ndjekje tek Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve/Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë, problematika e rastit në fjalë, raportuar nëpërmjet shkresës me nr. 1014/1 prot., datë 21.09.2023, të KMD-së.*
- *Nëpërmjet shkresës me nr. 4373/1 prot., datë 10.10.2023, Administratori i Njesisë Bashkiake Nr. 5, Tiranë, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve e Kopshteve, më një kërkesë për regjistrimin e fëmijëve në Çerdhe e Kopsht, duke parashtruar, ndër të tjera, si më poshtë:*

*“Familja banon në rrugën “Margarita Tutulani”, pranë Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë. Me datë 05.10.2023, kemi kontaktuar me nënën e fëmijëve mbi problematikën e mosregjistrimit të fëmijëve të saj 1.5 vjeç dhe 4 vjeç në çerdhen “Borëbardha” e kopshtin “Duarartët”, pranë kësaj Njësie Administrative.*

*Familja më parë ka jetuar në Athinë, në shtetin grek, dhe më pas znj. K është kthyer e vetme me fëmijët në Tiranë. Nëna jeton në banesën e prindërve të saj. Nëna ka një vajzë 14 vjeç nga martesja e parë, pasi bashkëshorti i ka vdekur, dhe aktualisht është në proces divorci me bashkëshortin e dytë.*

*Familja gjendet në kushte jo të mira ekonomike. Nëna ka filluar punë si ndihmës kuzhinierë në një restorant, në mënyrë që të përballojë kostot e jetesës, dhe kërkon të regjistrojë fëmijët në kopsht e çerdhe, pasi është e vetmja mënyrë që ajo të punojë.*

*Nëna është shprehur se ka ditë që vajzën e madhe nuk e ka dërguar në shkollë, pasi është kujdesur për dy fëmijët më të vegjël duke i mbajtur në shtëpi. Nëna është shumë e shqetësuar pasi rrezikon të lërë punën se nuk ka kush të mbajë fëmijët.*

*Pasi kemi kontaktuar në telefon, në numrin zyrtar të Drejtorisë së Kopshteve e Çerdheve, punonjësja e asaj zyre na ka shprehur se e kanë në konsideratë këtë kërkesë dhe se i kanë kthyer përgjigje zyrtare nënës së fëmijëve, se kopshti e çerdhja ku ajo kërkon të regjistrojë fëmijët janë të mbushura përtej kapacitetit të lejuar, dhe sapo të këmi hapësirë do e njoftojmë”.*

2. *Pas marrjes dijeni të faktit shqetësues, që ankuesja kishte larguar për disa ditë nga shkolla edhe vajzën 14 vjeçare, në mënyrë që ajo të kujdesej në shtëpi për motrën e vëllain e saj*

më të vogël; Komisioneri nëpërmjet e-mailit të datës 18.10.2023, (përsëritur edhe me datë 27.10.2023) iu drejtua sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve e Kopshteve, në adresën elektronike: [femijet@tirana.al](mailto:femijet@tirana.al). Njëherësh Komisioneri komunikoi edhe në rrugë telefonike me një nga punonjëset e kësaj Drejtorie, e cila u shpreh se po punonin për zgjidhjen e kësaj problematike.

3. Nëpërmjet e-mailit të datës 31.10.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve e Kopshteve/Bashkia Tiranë, informoi Komisionerin se: *“Fëmijët e ankueses M. K janë regjistruar, sipas kërkesës për regjistrim në çerdhen e kopshtin përkatës.”*
4. Në vijim të verifikimit të sa më sipër, Komisioneri komunikoi me subjektin ankues, M. K. Sipas procesverbalit të mbajtur me datë 31.10.2023, ora 09:21, nga inspektorët e KMD-së, ndër të tjera, pasqyrohet situata si më poshtë citohet:

*“Sot, në datën 31.10.2023, ora 09:21, u realizua biseda telefonike me ankuesen M. K, (ankesa me nr. 172 regj., datë 19.09.2023) e cila, falenderoi Komisionerin për punën dhe ndihmesën e dhënë në zgjidhjen e problematikës së saj për regjistrimin e dy fëmijëve respektivisht në kopshtin “Duarartët” dhe çerdhen “Borëbardha”, në Njësinë Administrative nr.5, Tiranë, dhe deklaroi se e konsideron të zgjidhur problematikën e saj dhe do të tërhiqet nga ankesa e paraqitur pranë KMD-së.”*

Pas ndërmjetësimit të Komisionerit lidhur me problematikën e mosregjistrimit të fëmijëve të ankueses në kopshtin e çerdhen përkatëse, nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, u morën masa konkrete të menjëhershme lidhur me regjistrimin e fëmijëve në kopshtin “Duarartët” dhe çerdhen “Borëbardha”, në Njësinë Administrative nr.5, Tiranë.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesja M. K, e cila është tërhequr nga ankesa, pasi falë ndërhyrjes në KMD-së, është arritur qëllimi për të cilin ajo kishte depozituar këtë ankesë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”,* KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 172 Regj., datë 19.09.2023, të subjektit ankues M. K, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**